



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT  
TË PUSHTETIT LOKAL



KOSOVO LOCAL  
GOVERNMENT  
INSTITUTE



# AUDITIMI SOCIAL

---

KOMUNA E VITISË  
JANAR, 2025

## PËRMBAJTJA

RRETH KLGI.....	7
RRETH MAPL.....	7
HYRJE.....	8
PROFILI I KOMUNËS.....	9
KONCEPTI I AUDITIMIT SOCIAL.....	10
PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL.....	11
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	12
HAPAT E PROCESIT TË AUDITIMIT SOCIAL.....	13
METODOLOGJIA.....	13
RRETH PROJEKTEVE.....	15
GJETJET KRYESORE.....	16
KOMENTET E KOMUNËS.....	18
LISTA E GRUPIT TË AUDITIMIT SOCIAL.....	19



## RRETH KLGI

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI) është organizatë profesionale e dedikuar për të përmirësuar dhe forcuar qeverisjen lokale në Kosovë.

KLGI është themeluar në vitin 2008 bazuar në modele ndërkombëtare të organizatave profesionale. Instituti synon të kontribuojë në vazhdimësinë e procesit të reformave në çështjet e qeverisjes lokale dhe të avancojë sistemin e decentralizuar të qeverisjes, me theks të veçantë në rritjen e llogaridhënies dhe zhvillimin e kapaciteteve në nivel komunal.

Fokusi i KLGI-së është në konsolidimin demokratik dhe mirëfunksionimin e institucioneve të nivelit lokal lidhur me praktikat dhe trendët bashkëkohore. Në këtë perspektivë, KLGI-ja është aktive përmes hulumtimeve, avokimit, rrjeteve, këshillave për politika publike, ngritjen e kapaciteteve dhe forma të tjera të mbështetjes për qeverisjen lokale.

## RRETH MAPL

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) është institucion i administratës shtetërore të Republikës së Kosovës, e themeluar në vitin 2004. Funkcionin e saj, MAPL e ushtron në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Përgjatë këtyre viteve, MAPL ka qenë direkt e përfshirë në procesin e reformës së pushtetit lokal, respektivisht shtrirjen e procesit të decentralizimit në vend, sigurimit të kompetencave të mjaftueshme të pushtetit lokal dhe ushtrimit të tyre në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin e zbatueshëm. MAPL ndjek një politikë të afirmimit të të drejtave të komunave në rregullimin e çështjeve publike, krijimit të kapaciteteve të mjaftueshme të komunave për të ushtruar veprimtarinë e tyre në pajtim me parimin e ligjshmërisë, subsidiaritetit, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit dhe parimeve të tjera të qeverisjes së mirë.

Misioni i Ministrisë është të rritet autonomia lokale dhe të forcohet aftësia e Komunave, që nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe përfaqësimit demokratik, të ofrohen shërbime me kosto efektive për të rritur cilësinë e jetës, sigurinë dhe ekonominë lokale.

## HYRJE

Auditimi Social, i zbatuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale e i mbështetur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në Kosovë, ka për qëllim forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive gjithëpërfshirëse dhe kohezive.

Ky raport është përgatitur nga Grupi i Auditimit Social, me përfaqësim gjithëpërfshirës, gra, burra, të rinjë, të moshuar, nga profesione dhe statuse të ndryshme sociale në komunën e Vitisë.

Projektet e audituara nga grupi:

1. LOT IV - Ndërtimi i Sheshit në qendër- Faza e dytë, dhe rruga "28 Nëntori" në Viti;
2. LOT II - Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kalldrëm rreth lumit Moravë Viti.

Raporti paraqet metodologjinë e zbatuar nga Grupi i Auditimit Social, përfshirë:

- i. Mbledhjen e informacionit; sigurimin e kontratave; analizimin e kontratave sipas parametrave, krahasimet me modelet dhe standardet;
- ii. Monitorimin në terren; takimet me përfitues dhe informacione rrethore (bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë);
- iii. Hartimin e gjetjeve dhe rekomandimeve; si dhe
- iv. Adresimin/konfirmimin e gjetjeve në takimin me komunën.

Instituti KLGJ, nëpërmjet auditimit social ka tri synime:

1. Rritjen e informacionit dhe njohurive për Auditimin Social;
2. Përfshirjen e qytetarëve në proceset publike lokale;
3. Ndërtimin e praktikave për angazhim të vazhdueshëm publik.

# PROFILI I KOMUNËS

## Viti

### Zona dhe Popullsia

Komuna e Vitisë gjendet në zonën juglindore të Kosovës. Përfshin një sipërfaqe prej 270 km<sup>2</sup> dhe përfshin qytetin e Vitisë dhe 38 fshatra. Sipas Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave të Kosovës 2024, popullsia e përgjithshme është **35,566** banorë rezidentë.

### Struktura Qeverisëse dhe Pasqyra Politike

Numri i përgjithshëm i votuesve në komunën e Vitisë të regjistruar për zgjedhjet e fundit komunale të mbajtura në tetor 2021 ishte 48,084 duke përfshirë votuesit jashtë Kosovës. Pjesëmarrja në votime ishte 42,5 për qind/20,456 votues (burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve).

*Përbërja Kuvendit Komunal nga Zgjedhjet Lokale 2021:*

#### 1. Legjislativi

Kuvendi Komunal: **27 ulëse**

#### Rezultatet e zgjedhjeve:

<b>LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës</b>	39,74%	14
<b>LVV – Lëvizja Vetëvendosje</b>	27,24%	10
<b>PDK – Partia Demokratike e Kosovës</b>	27,04%	5
<b>AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës</b>	3,99%	2

#### 2. Ekzekutivi

Kryetari i Komunës: **Sokol Haliti (LDK)**

Drejtoritë e Komunës: **10**



### TË ARDHURAT BUXHETORE

Kategoria	Vlera
a. Të hyrat vetanake	1,270,127€
b. Granti i Përgjithshëm	7,705,065€
c. Granti Specifik për Arsim	6,887,645€
d. Granti Specifik për Shëndetësi	1,927,785€
e. Shërbime Rezidenciale	155,000€
<b>Totali</b>	<b>17,945,622€</b>

### BUXHETI NË KATEGORI

Kategoria	Vlera
a. Pagat dhe shtesa	9,887,124€
b. Mallra dhe shërbime	3,172,919€
c. Shpenzime komunale	300,000€
d. Subvencionet dhe transferet	720,00€
f. Investimet kapitale	3,865,579€

*Komuna e Vitisë ka:*

*Buxhet total: 17,945,622 Euro*

*Staf komunal: 1,181*

## KONCEPTI I AUDITIMIT SOCIAL


Auditimi Social, është njëri nga mjetet e informimit, përfshirjes dhe angazhimit qytetar në proceset komunale. Si dhe njëra nga metodat, e kontributit konstruktiv të akterëve (qytetarëve, shoqërisë civile, grupeve te interesit) e në veçanti e përfituesve fundorë të investimeve komunale.

Ky proces synon të kontribuojë reciprokisht në dy dimensione: në njërën anë të zgjerojë informacionin, njohuritë dhe përfshirjen e qytetarëve në të gjitha stadet e zhvillimit të investimeve komunale (planifikim, zbatim, monitorim si dhe vlerësim); si dhe në anën tjetër, të rrisë interesin e autoriteteve lokale, për të forcuar pronësinë dhe kontributin direkt të qytetarëve në investimet komunale. Në fokus, për të rritur nivelin e performancës së komunave, në të gjitha stadet e investimeve kapitale nëpërmjet kontributit dhe monitorimit qytetar.

Auditimi Social është në frymën e parimeve të qeverisjes së mirë, duke siguruar se autoritetet lokale, marrin parasysh nevojat, kërkesat dhe interesat publike në proceset e politik-bërjes dhe vendimmarrjes komunale. Si dhe duke siguruar parimet e gjithëpërfshirjes dhe kohezionit social në komuna. Auditimi Social merr kuptim të plotë, atëherë kur publiku ka informacion, është i përfshirë dhe ka rol në proceset e politikave lokale. Përtej mjeteve dhe mekanizmave të zakonshëm, Auditimi Social, ka karakterin e bashkë-dizajnit dhe bashkë-krijimit të politikave lokale. Si hisedar, ai merr edhe rolin e monitoruesit dhe vlerësuesit të zbatimit dhe ndikimit real të investimeve komunale. Kësisoj, synimi parësorë është të forcojë besimin reciprok në mes qytetarëve dhe autoriteteve lokale.

Instituti KLGI, përgjatë këtij cikli të Auditimit Social, ka vendosur në fokus që pronësia e procesit të bartet tek organizatat dhe aktivistët lokalë, kjo duke siguruar qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të proceseve. E, njëkohësisht, që t'i ofrojë nivelit lokal metodologji, mjete dhe kapacitete, për të shtrirë Auditimin Social edhe në projektet tjera komunale.


Për të siguruar qasje sa më efektive në zbatim, Instituti KLGI, është angazhuar në tri (3) dimensione: i. Grupet e auditimit të reflektojnë gjithëpërfshirjen e qytetarëve; ii. Njohja e vlerave dhe interesave të komunitetit lokal; iii. Ndërturja e dy të parave me proceset, praktikat dhe mekanizmat komunalë.



## PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL

### Themelimi i Grupit të Auditimit Social/Trajnimi

Fillimisht më datë: **28 qershor 2024** u zhvillua takimi koordinues dhe trajnimi për gjashtë (6) organizatat partnere të përfshira në procesin e Auditimit Social. Nëpërmjet letrës informuese, më datë: 05 korrik 2024, është njoftuar Komuna e Vitisë mbi projektet e përfshira dhe organizatën partnere lokale që do ta zbatojë Auditimin Social. Grupi i Auditimit Social, u themelua më datë: 25 korrik 2024. Në takim morën pjesë 15 qytetarë, prej tyre 14 burra dhe 1 grua. Grupi i Auditimit ishte divers, duke përfshirë, dallime në moshë, profesion, përfaqësim dhe vendbanim. Njëkohësisht, u zhvillua trajnimi mbi Auditimin Social i ndarë në tri sesione (njohja e legjislacionit mbi qeverisjen lokale; konceptet dhe metodologjia e Auditimit Social; shembujt dhe praktikat dhe analiza e kontratës).



### Takimi i dytë/Vizita ne teten

Takimi i dytë është mbajtur më **14 tetor 2024**, ku pjesëmarrës nga grupi ishin 11 persona, nga ta 3 gra. Fillimisht, u reflektua mbi metodologjinë, stadin e zbatimit të kontratës, analiza e përgjithshme, kriteret, parimet dhe standardet e investimit publik. Po ashtu, u vendosen fokuset e trajtimit nga grupi i auditimit. U ndanë rolet: mbajta e shënimeve, vrojtimit (mjedisi, pjesa inxhinierike, ndjeshmëria gjinore, grupeve të cenueshme, bizneset); faktimi (fotografimi) i gjetjeve.

### Takimi i tretë/hartimi i gjetjeve

Takimi i tretë është mbajtur më **14 nëntor 2024**, ku grupi i auditimit ka analizuar veç e veç secilën gjetje, fillimisht ka analizuar detajet e kontratës dhe realizimin, pastaj, ka vlerësuar anët pozitive dhe mangësitë e planifikimit. Pas kësaj, grupi ka hartuar gjetjet dhe rekomandimet.

### Takimi me komunën/adresimi, konfirmimi i gjetjeve dhe ndarja e rekomandimeve

Takimi i katërt me komunën është mbajtur me datë: 15 janar 2025. Grupi i Auditimit Social në Viti ka ndarë gjetjet dhe rekomandimet me Kryetarin e Komunës dhe ekipin, për projektet e monitoruara. Ku u diskuan gjetjet dhe u ndanë rekomandimet e projektit të përfshirë në këtë proces të monitorimit. Pas komenteve të komunës, janë reflektuar komentet në raportin final.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës **qershor 2024 - shkurt 2025**, Instituti KLGI me mbështetjen nga MAPL, ka zbatuar procesin e Auditimit Social në gjashtë (6) komuna me nga dy projekte, pjesë e financimit nga Granti i Performancës komunale, përfshirë edhe Vitisë.

Në Komunën e Vitisë kanë kaluar në procesin e Auditimit Social këto projekte:

1. **LOT IV - Ndërtimi i Sheshit në qendër- faza e dytë, dhe rruga "28 Nëntori" në Viti;**
2. **LOT II - Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kalldrëm rreth lumit Moravë Viti.**

Instituti KLGI, ka përzgjedhur organizatën partnere dhe koordinatorin për Komunën e Vitisë, duke e përfshirë në platformën [www.klgi-platform.com](http://www.klgi-platform.com), ku janë ndarë dhe zbatuar detyrat në këtë sekuencim: koordinatorët, pas vlerësimit të shtrirjes gjeografike të projekteve si dhe strukturës së tyre (rrugë, parqe, shtigje të ecjes, terrene sportive, pajisje për nevoja të komunës dhe punime tjera në infrastrukturë), kanë identifikuar dhe përzgjedhur qytetarët (aktivistë, pjesë e shoqërisë civile, anëtarë të këshillave lokalë, profesionistë, përfaqësues apo direkt pjesëtarë të grupeve të nën-përfaqësuar dhe përfitues fundorë); Instituti KLGI dhe koordinatori, kanë përcaktuar dhe përgatitur takimin e parë/trajnimin, ku më pas është rivlerësuar për nevojën e zgjerimit të grupit pas analizimit fillestar të projektit si dhe kanë krijuar grupin e komunikimit elektronik; koordinatori dhe grupi kanë përcaktuar takimet e dyta/vizitat në terren, duke konsultuar përfituesit dhe marrë informacione rrethanore nga bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë; pas mbledhjes së informacioneve nga terreni, në takimin e tretë, janë hartuar gjetjet dhe nxjerrë rekomandimet; në takimin me komunën janë adresuar/konfirmuar gjetjet dhe janë paraqitur rekomandimet nga procesi i Auditimit Social.

### 1. **LOT IV -Ndërtimi i Sheshit në qendër- faza e dytë, dhe rruga "28 Nëntori"në Viti;**

Si çështje kyçe dalin: zbatimi i projektit brenda afatit të parashikuar (përpara Vitit të Ri 2024-2025); rregullimi i qasjes për këmbësorët dhe qytetarët; ndikimi i punimeve në aktivitetet e përditshme të bizneseve lokale; dhe sigurimi i një plani për furnizimin e bizneseve. Në këtë fazë të zbatimit, është synuar vlerësimi i transparencës për progresin e projektit; adresimi i shqetësimeve të bizneseve për furnizimet dhe qasjen; koordinimi me kontraktorët për të shmangur vonesat; dhe garantimi i një sheshi të hapur dhe funksional. Grupi i Auditimit Social, nga takimet në terren ka nxjerr në pah nevojën e përsheptimit të punimeve për përfundimin e projektit në afatin e parashikuar; Zbatimi i një sistemi fleksibël për qasjen e bizneseve, duke siguruar leje të posaçme për furnizime; planifikimi i një qasje për të minimizuar ndikimin e punimeve në aktivitetin ekonomik të zonës; rregullimi i qasjes së këmbësorëve dhe sigurimi i hapësirave funksionale për komunitetin. Ndërkaq, komuna si koment të përgjithshëm thekson se projekti është prioritar për zhvillimin urban dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve; janë identifikuar disa shqetësime nga bizneset lokale, për të cilat komuna po ndërmerr masa korrigjuese; përkushtimi mbetet për përfundimin e projektit sipas standardeve dhe brenda afateve të parashikuara.

### 2. **LOT II - Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kalldrëm rreth lumit Moravë - Viti.**

Si çështje kyçe dalin niveli i zbatimit të kontratës; cilësia e punimeve dhe materialeve; përputhshmëria me standardet teknike (vendosja e fugave, qasjet për personat me nevoja të veçanta, koshat e mbeturinave); përdorimi i hapësirës në kalldrëm dhe nivelimi i qasjes me rrugët anësore. Ndërkaq, komuna në komentin e përgjithshëm thekson se projekti ka rëndësi për përmirësimin e estetikës dhe funksionalitetit urban; janë identifikuar disa mangësi gjatë zbatimit, por komuna ka ndërmarrë masa për adresimin e tyre. Shprehet përkushtim për përfundimin e punimeve sipas standardeve të parapara.

*\*Detajet janë të paraqitura në pjesën e gjetjeve, rekomandimeve dhe komenteve të komunës.*

## HAPAT E PROCESIT TË AUDITIMIT SOCIAL

Procesi i auditimit social, referohet në metodologjinë e punës përfshirë:

- i. **Mbledhja e informacionit** – sigurimin e kontratave; analizimin e kontratave sipas parametrave, krahasimet me kriteret, parimet dhe standardet;
- ii. **Vizitat/monitorimin në terren** – takimet me përfitues dhe informacione rrethore (bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë) dhe komentet e anëtarëve të grupit;
- iii. **Puna e grupit të Auditimit Social** – hartimin e gjetjeve dhe rekomandimeve;
- iv. **Takimi në komunë** – adresimin/konfirmimin e gjetjeve në takimin me komunën dhe ndarja e rekomandimeve.

## METODOLOGJIA

**Përzgjedhja e Projekteve, Komunave dhe Grupit të Auditimit**

Instituti KLGJ, referuar **Aneksit I**, të kontratës (KLGJ – MAPL) duke marrë listën e projekteve të bashkëfinancuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunat në kuadrin e grantit të performancës komunale. Ky rregull ka vlejtur në tri (3) komuna (*Viti, Skenderaj dhe Kaçanik*), me nga një projekt në tri (3) komuna (*Drenas, Shtime dhe Ranillug*) dhe me tri (3) e më shumë projekte në (*Skenderaj dhe Shtime*) projekte të bashkëfinancuara nga skema e Grantit të Performancës komunale. Komunat ku është kryer Auditimi Social, ofrojnë një pasqyrim të kontekstit të përgjithshëm lokal, duke pasur parasysh, se përfshihen komuna të mëdha, të vogla, komuna kufitare, me shtrirje të madhe dhe të vogël gjeografike, me përfaqësim të ndryshëm të komuniteteve etnike.

Instituti KLGJ, procesin e përzgjedhjes së grupeve të Auditimit Social e ka shtrirë në tri nivele dhe dimensione: i. Përzgjedhja e koordinatorëve, aktivistë apo të angazhuar në komunitetin lokal; ii. Gjithëpërfshirja (diversiteti) brenda grupit të Auditimit Social dhe iii. Zgjerimi i grupit të Auditimit Social, sipas kontekstit dhe strukturës së projekteve të monitoruara (parqe, rrugë, terrene sportive, investime në ambient), duke siguruar edhe përfshirjen e përfituesve fundorë.

## Fokusi Grupit të Auditimit Social në Viti

Në projektin “Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kalldrëm rreth lumit Morava – Viti”, fokusi ka qenë në zbatimin e kontratës dhe përputhshmërinë me specifikimet teknike, cilësinë e punimeve dhe materialeve, si vendosja e fugave dhe kalldrëmit, si dhe rregullimin e trotuareve. Përtej kësaj, janë adresuar aspektet funksionale dhe rrethanore, duke përfshirë qasjen për personat me aftësi të kufizuara, vendosjen e koshave të mbeturinave, ndriçimin dhe përdorimin optimal të hapësirës në kalldrëm, si dhe rregullimin e nivelit të rrugës për të garantuar siguri dhe qasje për këmbësorët.

Në projektin **Ndërtimi i Sheshit në Qendër - Faza e Dytë, dhe Rruga "28 Nëntori"** në Viti, problematikë kryesore ka qenë nëse projekti do të përfundojë para fillimit të Vitit të Ri 2024-2025. Po ashtu, është ngritur çështja nëse sheshi do të mbetet i hapur apo i mbyllur për qarkullim, pasi sipas indikacioneve nga bizneset lokale, ekziston shqetësimi se sheshi mund të mbetet i mbyllur për 24 orë. Një tjetër çështje e ngritur ka të bëjë me qasjen e bizneseve në zonën e sheshit, për të cilën kërkohet që të sigurohet një sistem i kalueshëm me leje të veçantë për furnizimet gjatë një kohe të caktuar.

Indikatorët e performancës të përgatitur nga Grupi i Auditimit Social për projektin e monitoruar janë:

1. A ndoqi zbatimin një plan të qartë veprimi?
2. A ka pasur vonesa në zbatimin e projektit?
3. Cilat ishin arsyet e vonësës?
4. Si është realizuar buxheti në relacion me planin?
5. Cilat ishin arsyetimet për çdo devijim buxhetor?
6. Cilat janë rekomandimet për të përmirësuar më tej projektin/?
7. A është krijuar dhe/ose përdorur ndonjë mekanizëm ankesash gjatë zbatimit?
8. A ka ndonjë ankesë të veçantë në lidhje me projektin/shërbimin në fjalë?

Përtej indikatorëve të vlerësimit të zbatimit, monitoruesit kanë nxjerrë të dhëna edhe për ndikimin në mjedis:

1. A ndikon projekti/shërbimi në degradimin e ambientit?
2. A ndikon projekti/shërbimi në cilësinë e ujit?
3. A ndikon projekti/shërbimi në florë ose faunë?
4. A ndikon projekti/shërbimi në rritjen/zvogëlimin e dyoksidit të karbonit?

Kërkesat për informacion/dokumente dhe pyetjet e dërguara nga Grupi i Auditimit Social në Komunën e Vitisë:

- Kontratat me detaje janë gjetur në ueb faqen e komunës;

Grupi i Auditimit Social në takim me komunën ka adresuar këto pyetje?

**“Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kalldrëm rreth lumit Morava – Viti”:**

- A ka pasur konsultime me qytetarët dhe grupet e interesit në fazën e planifikimit dhe projektimit?
- Si do të zgjidhet çështja e përdorimit për veturat dhe si shëtitore?
- Si planifikohet të rregullohet përdorimi nga personat me aftësi të kufizuara?
- Si do të zgjidhet çështja e fiksimit të kalldrëmit dhe eliminimi i pluhurit?

## Ndërtimi i Sheshit në Qendër - Faza e Dytë, dhe Rruga "28 Nëntori":

- A ka pasur konsultime qytetarët dhe grupet e interesit para projektimit të sheshit?
- A janë marrë parasysh, ndikimi i ndërtimit në mobilitetin urban, bizneset dhe banorët?
- Në projektim, a janë marrë parasysh rregullimi i rrjetit nëntokësor?
- A pritet që të rritet dinamika e punimeve, në mënyrë që të ulen efektet për bizneset?

## RRETH PROJEKTEVE

Projekti	"Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kalldrëm rreth lumit Morava – Viti": Numri i prokurimit: 657-23-6765-5-1-1
Çmimi total i punëve në kontratë	277,777.50€
Statusi i kontratës	Në zbatim

**Autoriteti Kontraktues:** Komuna e Vitisë

**Zbatues:** Operatori Ekonomik OE - Grupi i Operatorëve Ekonomik: KUSHTRIMI NM SH.P.K.; "Burimi- E" Sh.p.k., Viti,

### RIKAPITULIM I PËRGJITHSHËM

NR.	Kategoritë	Shuma
1	Punët përgatitore	0.00 €
2	Punët tokësore	0.00 €
3	Punët montuese	0.00 €
4	Punët e betonimit	0.00 €
5	Gropa septike	0.00 €

\*Rikapitulimi i përgjithshëm nga OE nuk gjendet në kontratën e publikuar nga Komuna e Vitisë.

\*Rikapitulimi gjendet vetëm në para-masa dhe para-llogari në projektin kryesor.

Projekti	Ndërtimi i Sheshit në qendër- Faza e dytë, dhe rruga "28 Nëntori" në Viti. Numri i prokurimit: 657-23-6765-5-1-1
Çmimi total i punëve në kontratë	87,754.30 €
Statusi i kontratës	Në zbatim

**Autoriteti Kontraktues:** Komuna e Vitisë

**Zbatues:** Operatori Ekonomik OE – G.O.E. GASHI ING SH.P.K.; ENGINEERING RK SH.P.K.; ASFALT GROUP SH.P.K.; GURËTHYESI CELI AG SH.P.K., Nebih Hodo Kuqi, Nr 3, 23000, Suharekë,

### RIKAPITULIM I PËRGJITHSHËM


NR.	Kategoritë	Shuma
1	Punët përgatitore	13.378.00 €
2	Punët e gërmimit	21.644.00 €
3	Superstruktura (pjesa e sipërme e sheshit)	223.999.60 €
4	Drunjtë dekorativë	2.730.00 €
5	Fontana, ulëset dhe gjelbërimi	65,101,25 €


\*Rikapitulimi i përgjithshëm nga OE gjendet në kontratën e publikuar nga Komuna e Vitisë.


\*Rikapitulimi gjendet vetëm në para-masën dhe parallogaritë në projektin kryesor.


## GJETJET KRYESORE

### “Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kalldrëm rreth lumit Morava – Viti”

 Qasja për personat me aftësi të kufizuara është e mangët, duke përbërë pengesë për lëvizjen dhe përdorimin e infrastrukturës.


 Në disa pjesë, niveli i rrugës/shëtitorës dhe rrugëve anësore nuk janë të adaptuara, duke shkaktuar vështirësi për këmbësorët dhe pengesa për automjetet.


 Ka një shfrytëzim jo optimal të hapësirave (ulëseve) çka ndikon negativisht në funksionalitetin e zonës. Kjo, si rezultat i përdorimit të rrugës edhe nga automjetet.

 Shtyllat e ndriçimit nuk janë të fiksuara mjaftueshëm, çka ka shkaktuar lëvizjen e disa prej tyre. Si pasojë, një shtyllë është rrëzuar, ndërsa dy të tjera janë anuar.


### Përtej Projekteve:


#### Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kalldrëm rreth lumit Morava – Viti”


 Mos vendosja e fugave (me llaç special) në kalldrëm ka shkaktuar pluhur të konsiderueshëm. Ndërkaq, lidhja e dobët mes kalldrëmit shpërfaq rrezikun e dëmtimit duke ndikuar në qëndrueshmërinë dhe cilësinë e investimit.

 Në disa segmente janë të vendosur kosha, në veçanti në rrugët hyrëse. Kjo pengon dukshmërinë e qasjes nga makina si dhe përdorimin e rrugës/shëtitorës.

#### Ndërtimi i Sheshit në qendër- Faza e dytë, dhe rruga “28 Nëntori” në Viti

 Bizneset kanë shprehur shqetësime se sheshi mund të mbetet i mbyllur për 24 orë, duke kufizuar qasjen për furnizime.

 Mungesa e qasjes (në afërsi) për klientët mund të krijojë probleme për bizneset. Nga praktikat, vërehet se përdorimi i shesheve, po ulet si pasojë e qasjes në parkingje.

 Vlerësohet e nevojshme që projekti të përfundojë brenda afatit të paraparë, për të mos shkaktuar probleme për bizneset dhe përdoruesit.

### Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kalldrëm rreth lumit Morava – Viti

- **Nivelimi me pjesët anësore:** Të realizohet një rregullim i nivelit ndërmjet rrugës/sheshit dhe rrugëve anësore për të lehtësuar lëvizjen e këmbësorëve dhe automjeteve;
- **Problemet me shtyllat e ndriçimit:** Të kryhet inspektimi teknik i të gjitha shtyllave dhe të fiksohen ato që janë të lëvizshme. Të zëvendësohen bazat e dëmtuara.

### Përtej Projekteve:

### Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kalldrëm rreth lumit Morava – Viti

- **Përmirësimi i lidhjes së kalldrëmit (fugave):** Të shqyrtohet mbushja e fugave me materiale cilësore për të parandaluar krijimin e pluhurit dhe lëvizjen e kalldrëmit. Kjo do të rrisë qëndrueshmërinë dhe cilësinë e rrugës, duke shmangur dëmtimet e mëtejshme.
- **Rregullimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara:** Të riparohet qasja në trotuare apo në shirit të veçantë për përdoruesit me karroca. Si dhe të vendoset sinjalistika.
- **Problemet me koshat e mbeturinave:** Të rishikohet vendosja e koshave të mbeturinave, duke i larguar nga rrugët hyrëse, dhe duke përdorur dizajne estetike dhe funksionale.
- **Përdorimi i hapësirës:** Të definohet përdorimi i hapësirës, mes përdorimit për rrugë dhe shëtitore, duke marrë parasysh edhe riparimin e lidhjes së kalldrëmit dhe eliminimin e pluhurit.

### Ndërtimi i Sheshit në qendër- Faza e dytë, dhe rruga “28 Nëntori” në Viti

- **Dinamika e punimeve:** Të bashkëpunohet me bizneset lokale për të mos ndikuar në aktivitetet e tyre dhe për të siguruar përfundimin brenda afatit të përcaktuar 2024-2025.
- **Mungesa e qasjes për klientët me vetura:** Të planifikohet shfrytëzimi i hapësirave të përshtatshme për parkim afër sheshit. Kjo do të rrisë qasjen e klientëve dhe do të minimizojë ndikimin negativ në të ardhurat e bizneseve lokale.

# KOMENTET E KOMUNËS

## Komentet e përgjithshme

*Në takimin me Kryetarin e Komunës dhe ekipin, u ndanë gjetjet dhe rekomandimet. Fokusi i diskutimit u vendos në këto çështje: përmbyllja e punimeve dhe ndërlidhja me pagesat; riorganizimi i shfrytëzimit si dhe zgjerimi i përdorimit; përmirësimi i disa segmenteve të punimeve. Përgjithësisht, komuna ka evidentuar këto mangësi. Megjithatë, mbetet që këto intervenime të bëhen në ndërhyrjet e ardhshme. Ka disa segmente, që nuk lidhen direkt me projektet, si menaxhimi i hapësirave për mbeturina (qasja e kontejnerëve) që kërkon zgjidhje nga një proces i veçantë në këtë sektor.*

## Komentet Specifike:

- **Rekomandimi:** Nivelimi me pjesët anësore
  - **Komenti i Komunës:** Në kuadrin e intervenimit për lidhjen (fugat) mes kalldrëmit, planifikohet edhe përmirësimi i qasjeve nga rrugët dhe objektet në këtë zonë. Dukë bërë edhe një rivlerësim të mobilitetit (lëvizjes) të kësaj rruge/shëtitorë.
- **Rekomandimi:** Shqyrtimi i përdorimit efikas të hapësirës
  - **Komenti i Komunës:** Për shkak të përdorimit edhe për lëvizjen e automjeteve, si dhe nga përdorimi i rërës (fugave), ulëset si dhe pjesa për shfrytëzim të parkut mbetet e kufizuar për përdorim. Sipas komunës, pas rishqyrtimit të projektit komuna do të vendos se si do të përdoret mobilieria (ulëset në atë zonë).
- **Rekomandimi:** Riparimi i shtyllave të ndriçimit
  - **Komenti i Komunës:** Komuna ka komunikuar me punë kryesin për përfundimin e punimeve, përfshirë fiksimin e ndriçimit, si dhe pjesëve të planifikuara në projekt.

## Përtej Projekteve:

- **Rekomandimi:** Përmirësimi i lidhjes së kalldrëmit (fugave)
  - **Komenti i Komunës:** Komuna ka evidentuar se përdorimi shumëfunksional dhe vendosja e kalldrëmit kërkon që lidhja mes tyre të bëhet me material (Ilaq special) në mënyrë që të shmanget pluhuri si dhe të bëhet lidhja e strukturës së kalldrëmit. Kjo pritet të realizohet në një intervenim të ri.
- **Rekomandimi:** Përmirësimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara
  - **Komenti i Komunës:** Përmirësimi i lidhjes së kalldrëmit (fuga) do të sigurohet qasje e barabartë për të gjitha kategoritë. Përdorimi i saj do të bëhet më gjithëpërfshirës.
- **Rekomandimi:** Qasja për furnizim të bizneseve
  - **Komenti i Komunës:** Komuna planifikon të rregullojë orarin për furnizim të bizneseve në zonë.
- **Rekomandimi:** Rregullimi i qasjes dhe i përdorimit të parkingjeve
  - **Komenti i Komunës:** Komuna vlerëson se është e nevojshme të sigurohet qasje për qytetarët(klientët me vetura) dhe konstaton se këtë do ta bëjë përmes planeve të mobilitetit.
- **Rekomandimi:** Zbatimi i punimeve sipas dinamikës
  - **Komenti i Komunës:** Komuna, ka komunikuar me punë kryesin për përfundimin e punimeve para afatit, por kjo është e ndërlidhur edhe me planin e pagesave.
- **Rekomandimi:** Problemet me koshat e mbeturinave
  - **Komenti i Komunës:** Për këtë rekomandim, komuna planifikon rregullimin e hapësirave për koshat e mbeturinave.

## LISTA E GRUPIT TË AUDITIMIT SOCIAL

	Emri dhe Mbiemri	Organizata/Profesioni
1	BESNIK IMERI	Koordinator i grupit
2	ERMAL ISMAJLI	Mësimdhënës/Historian
3	KUSHTRIM BEKTESHI	Farmacist
4	ADNAN RAMADANI	Shoqëri civile/ Politeia
5	IRFAN MALIQI	Gazetar
6	VETON ADEMI	Biznesmen
7	FLORENT YMERI	Biznesmen
8	KALTRINA YMERI	Ekonomiste
9	HALIL HASANI	Qytetar
10	FLORENT HAZIRI	Qytetar
11	EMIN REXHEPI	Inxhinier
12	ISA DELIU	Qytetar
13	MUSA DELIU	Qytetar
14	LIRIDON ZEJNULLAHU	Qytetar
15	NEBI ZUKA	Biznesmen

